

Burimet: deklarata R.J, FDH-20311; SHFDUÇK, *Feniksët...10*, 23-24, 103-104, 136-137; KMDLNJ, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 17-18, 130-131, FDH-23807; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; FHP, penale (Radoslav Mitrović dhe të tjerë), 2.03.2009, FDH-36787.

Smajl (Asllan) Jashari

(29.09.1951, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Shtëpia e Smajlit dhe të vëllait Tahirit gjendej në rrugë kryesore në **Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze**. Pas ngjarjeve në Likoshan/Likošane dhe Qirez/Čirez [të shikohen regjistrimet] Smajli dhe Tahiri e strehuan familjen në Skënderaj/Srbica, ndërkaq ata që të dy u kthyen në fshat. Smajli qëndronte tërë kohën në shtëpi, ndërkaq Tahiri natën e kalonte në dyqanin e tyre, jo larg shtëpisë familjare. Në mëngjes, më **5.03.1998**, kur filluan krismat e fuqishme, Tahiri ishte fshehur në tavanin e shitores. Ka zbritur vetëm më 7.03.1998, kur pushuan luftimet. Menjëherë ka shkuar te familja në Skënderaj/Srbica. U kthye më 10.03.1998. Në shtëpi, në krevat dhe muret kishte shumë gjurme gjaku, por Smajli mungonte. Ka shkuar në oborrin e depos së materialit dhe pajisjeve ndërtimore *Lah Tushila* dhe atje e ka gjetur trupin e të vëllait Smajlit. Në trupin e tij vëreheshin shumë plagë nga plumbat. Tahiri ka mësuar nga kushërira Sele se Smajlin e kishin vrarë pas betejës, kur policia serbe i kishte grupuar të gjithë banorë që kanë mbetur të gjallë te Fabrika e Municionit. Ajo e kishte parë një polic ta çonte Smajlin e përgjakur dhe të topitur nga rrahjet prapa fabrikës. Më pas, ajo ka dëgjuar një rafal.

Burimet: deklarata T.J, FDH-20315; SHFDUÇK, *Feniksët...10*, 225-226; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; *Pod Lupom: Kosovo-ljudska prava u vreme oružanih sukoba*, Buletini numër 26, FDH, Beograd, maj 1998, FDH-20114; FHP, penale (Radoslav Mitrović dhe të tjerë), 2.03.2009, FDH-36787.

Andreas (Gojko) Končarević

(11.01.1973, serb nga Novi Sad, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Rade (Bogdan) Radaković

(14.08.1961, serb nga Novi Sad, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Andreas dhe Rade me familjet e veta kanë jetuar dhe punuar në Novi Sad. Para kompletimit të trajnimit për polici, Andreas e kishte mbaruar shkollën për tekstil, ndërkaq Rade shkollën e mesme të makinerisë. Andreas ka qenë pjesëtar i Shërbimit të Sigurimit Shtetëror, përdërisa Rade ka qenë pjesëtar i NJSA-së. Që të dy kanë rënë në luftimet në **Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze** në *Mëhallën Jashari* më **5.03.1998**. Andreas dhe Rade u varrosën në Varrezat e Qytetit në Novi Sad më 7.03.1998.

Burimet: SMIP, *Teroristički...*, III, 346, 932; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 35, 56; *Likvidirani Adem Jashari i 25 Albanskih terorista*, Naša Borba, 09.03.1998, 2, FDH-35223.

Riza (Osman) Thaçi

(1931, shqiptar nga Buroja/Bročna, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, nëntë fëmijë)

Rizën e kanë plagosur rëndë më **5.03.1998**, kur forcat serbe kanë hyrë në **Burojë/Bročna**. Ai ndenji në fshat me gratë dhe fëmijët e familjeve Thaçi dhe Hajdini, përdërisa të tjerë u zhvendosën në pyll. Ishin të strehuar në bodrumin e kushëririt Ramadan Thaçit. Për një çast, Riza doli nga bodrumi për të parë nëse forcat serbe ende gjendeshin në fshat. Ushtarët serb e vërejtën dhe hapën zjarr ndaj tij. E qëlluan në shpinë, qafë dhe këmbë. Një ditë më vonë, familjarët e kanë bartur Rizën në spitalin e Pejës/Peć. Pas disa ditësh, e lëshuan nga spitali. Ishte në gjendje të rëndë shëndetësore. Ka ndërruar jetë më 22.03.1998. Të nesërmen, e kanë varrosur në varrezat e fshatit.

Burimi: deklarata P.T, FDH-20304.

Sadik (Miran) Kaçkini

(11.09.1953, shqiptar nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)